

VENDIM
Nr.538, datë 27.7.2011

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË AUTORIZIMIN DHËNË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.512, DATË 13.5.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në autorizimin dhënë “Enpower Albania” sh.p.k., filiali “Moncada Energy Group”, Itali të miratuar me vendimin nr.512, datë 13.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e autorizimit të ndërtimit të centralit elektrik me erë (parqe eolike) për “Enpower Albania” sh.p.k., të ndryshuar, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Republika e Shqipërisë
Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

DISA NDRYSHIME NË AUTORIZIMIN NR.1, DATË 24.3.2009 “PËR NDËRTIMIN E CENTRALIT ELEKTRIK ME ERË (PARQE EOLIKE) NGA SHOQËRIA ENPOWER ALBANIA SHPK

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 34/1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1701, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullores për procedurat e dhënies së autorizimeve, për ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë që nuk janë objekt koncesioni”, me autorizimin nr.1, datë 24.3.2009 të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës “Për ndërtimin e centralit elektrik me erë (parqe eolike) nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr.512, datë 13.5.2009 të dhënë shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., (filial në Shqipëri i “Moncada Energy Group” srl në Itali), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në adresën: Rr. “Ismail Qemali”, Pallati Gener, kati 2, zyra 10, Tiranë, Shqipëri, regjistruar në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS K72312008Q, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshon si vijon:

“Enpower Albania sh.p.k. autorizohet për ndërtimin e centralit elektrik me erë (parqe eolike) me karakteristikat e mëposhtme:

i) fuqi e instaluar deri në 501 MW;

ii) jo më shumë se 190 njësi gjeneruese (aerogjeneratorë) me kapacitet nga 2MW deri në 4,5MW secila;”.

2. Pika 4 ndryshon si vijon:

“Afatet kohore të realizimit të projektit për ndërtimin e centralit elektrik me erë, lidhja me sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe vënia në punë e parqeve eolike do të jenë ato të paraqitura në kronoprogramin e punimeve bashkëngjitur këtij autorizimi (data përfundimtare e

vënies në punë të gjithë centralit nuk ndryshon dhe është 31.12.2014)”.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço